



Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija Kosovske Agencije za Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

NR I VENDIMIT.:
DATA E VENDIMIT:

KPCC/D/A/108/2011
13/05/2011

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

- (1) Në secilën nga njëmbëdhjetë (11) kërkesat e identifikuar në pjesën A të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që paraqitësi i kërkesës ka vërtetuar pronësinë e bartësit të së drejtës pronësore për pronat e kërkuara..
- (2) Në kërkesat e përmendura në paragrafin (1) më sipër, Komisioni urdhëron që
 - (a) Paraqitësit të kërkesës ose bartësit të së drejtës pronësore, sipas rastit, t'i jepet posedimi i pronës së kërkuar;
 - (b) Çdo person, i cili e ka uzurpuar pronën, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe
 - (c) Nëse pala përgjegjëse ose çdo person i cili e ka uzurpuar pronën dështon të përmbushë urdhrin për lirimin e pronës brenda kohës së dhënë, të dëbohet nga prona.
- (3) Në secilën kërkesë të përmendur në kolonat përkatëse në pjesën A të Listës së bashkëngjitur, Komisioni më tutje vendos që kërkesat të hidhen poshtë për aq sa paraqitësi i kërkesës kërkon kompensim për dëmin material, apo humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar; dhe
- (4) Në secilën prej shtatëmbëdhjetë (17) kërkesave të identifikuar në pjesën B të listës së bashkëngjitur, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë.
- (5) Në kërkesat nr. 20160, 20161, 06609, 43288, 43289, 43290 dhe 43291, the Komisioni më tutje ia referon kontestin midis paraqitësve të kërkesave edhe palës përgjegjëse gjykatave kompetente vendore për vendosje.
- (6) Në rastet kur ka më shumë se një pronar, vendimet dhe urdhri i mësipërm nuk ndikojnë në të drejtat e asnjërit prej bashkëpronarëve përkatës.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ("Kuvendi") ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-079 duke miratuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 ("UNMIK/REG/2006/50") mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili miraton dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2007/5 ("UNMIK/ADM/DIR/2007/5"), e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin Nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("KPA") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi I kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushon së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji Nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit Nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079).

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-

ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e dytë më 11 dhe 13 maj 2011 me anë të konferencës telefonike. Gjithsej i janë paraqitur Komisionit 1,560 kërkesa bujqësore në seancën e njëzetë e dytë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata tjera relevante. Përveç kësaj, një kërkesë banesore e paraqitur në Komision u rikategorizuan nga Komisioni gjatë seancës si kërkesa bujqësore dhe rrjedhimisht përfshihet në vendimet që kanë të bëjnë me pronat bujqësore. Një kërkesë bujqësore që i ishte paraqitur Komisionit u kthye tek Sekretaria Ekzekutive nga Komisioni për verifikim të mëtejshëm dhe një kërkesë për prone bujqësore u tërhoq nga Sekretaria Ekzekutive gjatë seancës. Gjithsej, 1,559 kërkesa për prone bujqësore u shqyrtuan nga Komisioni gjatë seancës së njëzetë e dytë.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave, dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesa të përfshira në këtë vendim.

7. Në kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim zbatohet për 28 kërkesat e identifikuar në listën e bashkangjitur. Pjesa e mbetur prej 1,532 kërkesa për prone bujqësore të trajtuara nga Komisioni gjatë seancës trajtohen në dy vendimet e tjera pikërisht vendimin KPCC/D/A/106/2011 dhe vendimin KPCC/D/A/107/2011.

9. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundur të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

10. Të 28 kërkesat e përfshira në këtë vendim janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar, ose pala që ka shprehur interes ligjor në prona të tilla ("pala përgjegjëse"), ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parashihet që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksit e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksit I, II dhe III, respektivisht.

prej 30 ditësh të parashikuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

B. Kërkesa të miratuara.

1. Kërkesa nr. 40740

11. Në kërkesën nr. 40740, paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese e cila e identifikon atë si bartësin e së drejtës pronësore për pronat e kërkuara. Sekretaria Ekzekutive e ka verifikuar fletën poseduese si të vlefshme.

12. Gjatë notifikimit të pronës, Sekretaria Ekzekutive konstatoi dy palë të ndryshme që uzurpojnë pjesë të ndryshme të pronës. Ali Thaqi (më poshtë “pala e parë përgjegjëse”) shfrytëzon pjesën prej 10 ari të pronës së kërkuar, ndërsa Kadri Musliu (më poshtë “Pala e dytë përgjegjëse”) shfrytëzon pjesën tjetër prej 26 ari të pronës.

13. Pala e parë përgjegjëse nuk pohon për asnjë të drejtë në pronën e kërkuar por shpreh synimin e tij për ta blerë pronën nga paraqitësi i kërkesës.

14. Pala e dytë përgjegjëse pretendon se ai e ka shfrytëzuar pronën për njëzet vjet bazuar në një marrëveshje me paraqitësin e kërkesës. Ai pohon se deri dhjetë vite më parë i ka paguar qiranë paraqitësit të kërkesës. Pala e dytë përgjegjëse nuk ka mundur të dorëzojë dëshmi të dokumentuara në mbështetje të pretendimeve të tij.

15. Paraqitësi i kërkesës konfirmon se pala e dytë përgjegjëse e ka shfrytëzuar pronën për pesë ose gjashtë vite para konfliktit, por nuk e ka paguar rregullisht qiranë. Më tej ai konteston faktin se mund të ketë pasur marrëveshje qiraje midis tij edhe palës përgjegjëse.

2. Kërkesat nr. 27079, 27080, 27081 dhe 27082

16. Në kërkesat nr. 27079, 27080, 27081 dhe 27082, paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e tij si bartës i së drejtës pronësore. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* certifikatën për të drejta e pronës së paluajtshme të datës 11 shkurt 2011. Dokumenti është regjistruar në emër të paraqitësit të kërkesës dhe është verifikuar si e vlefshme. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ai humbi posedimin e pronave në qershor 1999 gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë.

17. Pala përgjegjëse pohon se prona i ka takuar familjes së tij, por ata e kanë humbur posedimin kur familja e tij migroi në Turqi në vitin 1924. Ai pretendon se familja e tij rimori posedimin pas kthimit të tyre në Kosovë, por e humbën posedimin përsëri në vitin 1965 kur prona u shtetëzua. Paraqitësi i kërkesës pretendon se ka bërë padi në gjykatë, por nuk është marrë vendim. Pala përgjegjëse nuk ka mundur të paraqes dokumente në mbështetje të pretendimeve të tij.

3. *Kërkesat nr., 40940, 40941, 40942, 40943 dhe 40944*

18. Në kërkesat nr. 40940, 40941, 40942, 40943, dhe 40944, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese e cila e identifikon atë si bartësen e së drejtës pronësore të pjesës ideale prej 1/7 të pronave të kërkuara. Sekretaria Ekzekutive ka verifikuar fletën poseduese si të vlefshme.

19. Pala përgjegjëse pretendon se gjyshi i tij është bashkëpronar i pronës. Ai ka paraqitur një aktgjykim të gjykatës më date 1 tetor 1945 në mbështetje të pretendimeve të tij, megjithatë, aktgjykimi nuk është i formës së prerë. Pala përgjegjëse nuk ka mundur të dorëzojë dokumente të tjera apo dëshmi në mbështetje të pohimeve të tij.

4. *Kërkesa nr. 10340*

20. Në kërkesën nr. 10340, paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar kërkesën në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar fletën poseduese e cila e identifikon atë si bartësin e së drejtës pronësore. Fleta poseduese është verifikuar si e vlefshme nga Sekretaria Ekzekutive. Sekretaria Ekzekutive ka gjetur *ex officio* certifikatën e të drejtave të pronës së paluajtshme nr. 82 datë 10 shtator 2008, e cila është në përputhje me fletën poseduese të dorëzuar dhe e identifikon paraqitësin e kërkesës si pronarin e pronës së kërkuar. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ai ka qenë në posedim të pronës së kërkuar deri në vitin 1999 kur ai u largua nga Kosova për arsye sigurie.

21. Pala përgjegjëse e cila ka uzurpuar pronën e kërkuar pohon se familja e tij ka qenë qiramarrës i pronës nga viti 1915 deri në vitin 1937 kur ata u dëbuan nga toka. Pala përgjegjëse ka dorëzuar deklarata dhe vendime të gjykatës për procedimin që gjyshi i tij Bislim Hasani ka ndjekur në instanca të ndryshme. Vendimi përfundimtar dhe i plotfuqishëm i Gjykatës Supreme në Beograd i datës 18 janar 1955 e konfirmon aktgjykimin e instancës së parë të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në të cilën gjykata refuzoi kërkesën e Bislim Hasani për pronën e kërkuar. Vendimi i Gjykatës Supreme është verifikuar si i vlefshëm nga Sekretaria Ekzekutive.

22. Nga sa u tha më sipër, Komisioni është i kënaqur, bazuar në dëshmitë që i posedon para tij se në kërkesat e identifikuar në pjesën A të listës së bashkangjitur:

- (a) paraqitësi i kërkesës ka të drejtën e pronësisë në lidhje me pronat e kërkuara;
- (b) as paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore nuk mund të ushtrojnë të drejtën pronësore për pronën; dhe
- (c) kërkesa në secilin rast përfshinë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

23. Rrjedhimisht, meqë paraqitësit e kërkesës në secilën nga kërkesat e identifikuar në pjesën A të listës së bashkangjitur kanë dëshmuar të drejtën pronësore

për pronën e kërkuar dhe në mungesë të një mbrojtje të vlefshme nga ana e palëve përgjegjëse, të gjitha këto kërkesa duhet të miratohen.

C. *Kërkesa të hedhura poshtë.*

24. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

25. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

26. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen nga gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykate vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit).

27. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj mbi pronën e kërkuar.

28. Ndonëse Komisioni ka pikëpamjen se humbja e posedimit që ka ndodhur përtej periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 megjithatë mund të konsiderohet që ndërlidhet drejtpërsëdrejti me, apo që është pasojë e konfliktit, varësisht nga rrethanat e rastit, ai duhet të konstatojë se ka disa dëshmi që tregojnë se humbja e posedimit përfshin rrethanat që janë pasojë e konfliktit.

1. Kërkesa të hedhura poshtë mbi bazën e mungesës së juridiksionit për kërkesat që janë parashtruar në gjykatën kompetente para datës së hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

29. Në kërkesën nr. 00036, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Pala përgjegjëse pranon se babai i tij e bleu pronën nga një pale e tretë në vitin 1997 dhe ka pasur posedimin e saj që nga ajo kohë. Ai deklaron se kur babai i tij mësoi faktin se paraqitësi i kërkesës ishte ende i regjistruar si mbajtës i së drejtës pronësore në kadastër, ai inicioi padi në Gjykatën Komunale të Prishtinës për konfirmimin e së drejtës pronësore për pronën e kërkuar.

30. Pala përgjegjëse, në mbështetje të mbrojtjes së tij, ka dorëzuar një aktgjykim të Gjykatës Komunale të Prishtinës të datës 8 nëntor 2005 në favor të babait të palës përgjegjëse. Aktgjykimi është vlerësuar si i vlefshëm nga Sekretaria Ekzekutive. Megjithatë, aktgjykimi nuk është i formës së prerë pasi është bërë ankesë ndaj tij. Në bazë të nenit 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesat që janë parashtruar në gjykatën kompetente para datës së hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Padia në këtë kërkesë është parashtruar në vitin 2005 në gjykatën kompetente dhe për rrjedhojë kërkesa duhet të hidhet poshtë.

2. Kërkesa të hedhura poshtë mbi bazën res judicata

31. Kërkesa nr. 22830 është vendosur më parë me vendim të Komisionit KPCC/A/13/2008, e cila më pas u shfuqizua me anë të KPCC/RES/24/2010 sa i takon kërkesës nr. 22830. Kërkesa nr. 22830 është dublikatë e kërkesë nr. 23027, d.m.th ajo është depozituar nga i njëjti paraqitës i kërkesës për të njëjtën pronë. Kërkesa nr. 23027 është refuzuar më parë nga Komisioni me anë të vendimit KPCC/D/A/78/2007. Pasi kërkesa është marrë në shqyrtim dhe vendosur me vendim të formës së prerë të Komisionit, kërkesa duhet të hidhet poshtë në pajtim me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

3. Kërkesa të hedhura poshtë për shkak të mungesës së autorizimit.

32. Në bazë të nenit 5.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079, kërkesat mund të paraqiten nga bartësi i së drejtës pronësore, anëtar i bashkësisë familjare ose nga personi fizik i autorizuar i cili posedon autorizim të vlefshëm të bërë sipas rregullit nga bartësi i së drejtës pronësore apo anëtar i bashkësisë familjare i atij personi. Në raste të jashtëzakonshme kur paraqiten probleme për sigurimin e autorizimit, Sekretaria mund të vërtetojë një dokument alternativ i cili autorizon përfaqësuesin e paraqitësit të kërkesës.

33. Neni 1 i Rregullores së UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079 përcakton që si "Anëtar i Bashkësisë Familjare" përfshihen "bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martesës ose të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t'i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm apo personat që janë të obliguar ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm pavarësisht nëse ata persona kanë banuar apo jo në pronë së bashku me bartësin e së drejtës pronësore." Komisioni ka përcaktuar se, sipas ligjit të aplikueshëm, ky përkufizim përfshin përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve gjithashtu edhe prindërit, vëllezërit, motrat, gjyshërit dhe nipat/mbesat e

bartësit të së drejtës pronësore. Megjithatë, ky përkufizim nuk përfshin të afërmit nga lidhja martesore, dajallarët/ xhaxhallarët, tezet/hallat, nipat, mbesat apo kushërinjtë ose kushërinj të tjerë më të largët, të cilët duhet të paraqesin autorizimin për përfaqësimin e tyre në emër të bartësit të së drejtës pronësore ose anëtarit të bashkësisë familjare të bartësit të së drejtës pronësore. Individët të cilët nuk bien në përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare nuk mund të konsiderohen si paraqitës të kërkesave por si persona që synojnë të përfaqësojnë paraqitësin e kërkesës.

34. Kërkesat në të cilat personi që depoziton kërkesën nuk është anëtar i bashkësisë familjare, nuk mund të konsiderohen kërkesa të plota në përputhje me nenin 5.2 të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin. 03/L-079, pasi nuk është përmbushur kërkesa themelore procedurale, pikërisht autorizimi nga bartësi i së drejtës pronësore ose anëtari i bashkësisë familjare i bartësit të së drejtës pronësore.

35. Në kërkesat nr. 47326, 47327 dhe 47328, paraqitësi i kërkesës parashtroi fillimisht kërkesë në emër të babait të saj të ndjerë bartës i pretenduar i të drejtës pronësore. Gjatë përpunimit të kërkesës, Sekretaria Ekzekutive, vërejti se ka pasur mospërputhje midis emrit të babait të paraqitësit të kërkesës dhe emrit të bartësit të së drejtës pronësore sipas dokumenteve mbështetëse, dhe më 18 mars 2011, Sekretaria Ekzekutive kontaktoi paraqitësin e kërkesës për sqarim. Paraqitësi i kërkesës deklaroi në fakt se artësi i ndjerë i së drejtës pronësore është stër xhaxhai/daja, pra xhaxhai/daja i babait të saj. Rrjedhimisht paraqitësi i kërkesës nuk përmbush përkufizimin e anëtarit të bashkësisë familjare si përcaktohet në paragrafin 33 më sipër. Në këto rrethana, në mungesë të autorizimit nga anëtari i bashkësisë familjare, kërkesa duhet të hidhet poshtë.

36. Në kërkesat nr. 34698, 34699, 34700, 34701 dhe 34702 paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare për xhaxhain/dajën e tij. Pasi paraqitësi i kërkesës dështoi të ofrojë autorizim nga anëtari i bashkësisë familjare të mbajtësit të së drejtës pronësore, Sekretaria Ekzekutive kontaktoi paraqitësin e kërkesës duke i kërkuar atij të dorëzojë autorizimin që mungon. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se ai nuk ka mundësi të dorëzojë autorizimin e kërkuar. Rrjedhimisht kërkesa duhet të hidhet poshtë për shkak të dështimit të paraqitësit të kërkesës për të ofruar autorizim për të pasur zotësinë për të depozituar kërkesë në emër të mbajtësit të së drejtës pronësore.

4 Kërkesa të hedhura poshtë për shkak të humbjes së posedimit që nuk ndërlidhet me konfliktin.

37. Në kërkesën nr. 06609, paraqitësi i kërkesës ka depozituar kërkesë në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës ka ofruar fletën poseduese të vitit 2001 e cila e tregon atë si bashkëpronar të pronës. Fleta poseduese është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vlefshme.

38. Kërkesat nr. 43288, 43289, 43290 dhe 43291 janë parashtuar nga vëllai i paraqitësit të kërkesës në kërkesën nr. 06609 në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës ofroi fletën poseduese që tregon se ai ka në pronësi pjesën ideale prej $\frac{1}{4}$ të pronës kërkuar.

39. Pala përgjegjëse e cila është në posedim të të gjitha ngastrave të kërkuara në kërkesat nr. 06609, 43288, 43289, 43290 dhe 43291, pohon se babai e ka blerë pronën

e kërkuar në vitin 1978 nga xhaxhai i tij. Sipas palës përgjegjëse, babai i tij ka paguar çmimin e plotë të blerjes dhe ka qenë në posedimin e tokës që nga viti 1978 derisa vdiq në vitin 2007. Më tej, ai deklaroi se xhaxhai i tij e ka blerë pronën në vitin 1973 nga babai i paraqitësve të kërkesave, megjithatë prona mbeti e regjistruar në emër të babait të paraqitësve të kërkesave. Pala përgjegjëse deklaroi se babai i paraqitësve të kërkesës ka qenë në dijeni të shitjes së pronës nga xhaxhai i palës përgjegjëse tek babai i tij në vitin 1978, pasi babai i paraqitësve të kërkesave jetoi në të njëjtën komunë deri në vitin 1999. Pala përgjegjëse shpjegoi se ai nuk e kishte kontratën e blerjes midis babait të paraqitësve të kërkesës dhe xhaxhait të tij dhe nuk mundi ta gjejë atë pasi disa dokumente të familjes së tij janë djegur gjatë luftës.

40. Në përgjigjen e tyre, të dy paraqitësit e kërkesave konfirmuan se prona e kërkuar është shitur në vitin 1966 dhe nuk është shfrytëzuar nga familja e tyre që nga ajo kohë. Megjithatë paraqitësit e kërkesave pohojnë se blerësi nuk e kishte paguar çmimin e plotë të blerjes dhe se babai i paraqitësve të kërkesave kishte vazhduar të paguante faturat e taksës së pronës. Paraqitësit e kërkesave konfirmojnë se është bërë një kontratë blerje edhe pse ata nuk kanë kopje të saj, por se kontrata asnjëherë nuk është vërtetuar në gjykatë.

41. Komisioni konsideron se, në bazë të dëshmive para tij, paraqitësit e kërkesave në kërkesat me nr. 06609, 43288, 43289, 43290 dhe 43291 nuk përfshijnë rrethana që ndërlidhen drejtpërsëdrejti ose që kanë lindur nga konflikti i armatosur i vitit 1998-1999. Rrjedhimisht kërkesat duhet të hidhen poshtë.

42. Në kërkesën nr. 20160 dhe 20161, paraqitësi i kërkesës depozitoi kërkesë në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht i biri i bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pohon se bartësi i së drejtës pronësore është babai i tij i ndjerë dhe ka dorëzuar certifikatën e vdekjes si dëshmi. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar fletën poseduese që tregon e babain e tij si pronar i ngastrave të kërkuara. Ky dokument është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive. Paraqitësi i kërkesës deklaroi se nëna e tij Sindja mbajti posedimin e pronave të kërkuara deri në dhjetor 2004 kur ajo vdiq.

43. Dy persona të ndryshëm iu përgjigjën kërkesës pasi janë uzurpuesit aktualë dhe kërkojnë të drejtë ligjore në pronën e kërkuar.

44. Pala e parë përgjegjëse, Remzi Haradinaj, pohon se ai e ka kultivuar tokën e kërkuar për më shumë se njëzet vjet në bazë të një marrëveshje gojore me paraqitësin e kërkesës dhe nënën e tij. Pala e parë përgjegjëse deklaroi se më pas, në vitin 2001, e bleu pronën e kërkuar. Në mbështetje të pohimeve të tij, ai ka dorëzuar kontratën e blerjes të nënshkruar më 18 maj 2001 midis Sindja Pajovic, Biljana Pajovic-Mirjadic dhe Djurdje Pajovic si shitës dhe palës së parë përgjegjëse si blerës. Kontrata nuk është vërtetuar në gjykatë dhe për rrjedhojë nuk mund të verifikohet nga Sekretaria Ekzekutive. Pala e parë përgjegjëse dorëzoi gjithashtu një deklaratë të vërtetuar në Gjykatën Komunale të Vrsac-it, Serbi, datë 18 maj 2001, me anë të së cilës paraqitësi i kërkesës konfirmon se nënshkrimi në kontratën e pavërtetuar është i tij. Ky dokument është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive. Pala e parë përgjegjëse pohon se ai nuk mundi ta vërtetojë kontratën e blerjes pasi gjykatat vendore nuk funksiononin në vitin 2001. Kur ai u përpoq me vonë të vërtetojë kontratën, paraqitësi i kërkesës refuzoi të pranojë kontratën.

45. Pala e dytë përgjegjëse, Xhemajl Zhegrova, pretendon se ai e ka blerë pronën në vitin 1977 nga paraqitësi i kërkesës dhe ka pasur posedimin e saj që nga ajo kohë. Në mbështetje të pretendimeve të tij, pala e dytë përgjegjëse ka paraqitur një dokument të lëshuar nga Komuna e Vushtrrisë në lidhje me konsolidimin e tokës i datës 10 tetor 1984 sipas të cilit pretenduesi i mbajtjes së të drejtës pronësore ia ka shitur pronën palës së dytë përgjegjëse. Megjithatë, Sekretaria Ekzekutive nuk e ka bërë verifikimin e këtij dokumenti.

46. Paraqitësi i kërkesës mohon faktin që ai apo ndonjë pjesëtar i familjes së tij të ketë shitur pronën e kërkuar ndonjërit prej palëve përgjegjëse dhe pohon se kontrata e shitjes me palën e parë përgjegjëse është e falsifikuar. Ai pohon se kontrata nuk mund të ishte e vërtetë pasi nuk kishte nisur në atë kohë procedura e trashëgimisë në lidhje me babain e tij, bartësin e pretenduar të së drejtës pronësore dhe për rrjedhojë askush nuk kishte zotësinë ligjore për të shitur pronat e babait të tij.

47. Ndonëse paraqitësi i kërkesës dhe palët përgjegjëse kanë arsyeime të ndryshme për shfrytëzimin e tokës në të kaluarën, paraqitësi i kërkesës pohon se nëna e tij mbeti në posedim të pronave deri në dhjetor 2004, mjaft kohë pas mbarimit të konfliktit të armatosur në Kosovë. Sekretaria Ekzekutive e kontaktoi paraqitësin e kërkesës për të sqaruar nëse kërkesa përfshin në ndonjë mënyrë rrethana të ndërlidhura me konfliktin, ashtu si u pretendua fillimisht se humbja e posedimit ndodhi në vitin 1999. Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se nuk ka pasur humbje të posedimit për shkak të konfliktit të vitit 1998-99, por pas vdekjes së nënës së tij në vitin 2004, pronat u uzurpuan nga persona të panjohur. Rrjedhimisht Komisioni arrin në përfundimin se kërkesat duhen të hidhen poshtë pasi bien jashtë juridiksionit të Komisionit.

48. Në bazë të nenit 8.1 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 Komisioni ka kompetenca të referojë çështjet që dalin në lidhje me kërkesën, të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij, ose pjesë specifike të këtyre kërkesave, nëse gjykimi i këtyre pjesëve të veçuara nuk ngre çështje që janë përcaktuar në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, tek gjykata ose bordi administrativ apo tribunali kompetent vendor. Komisioni konsideron se kjo është qasja e duhur në rastin e kërkesave nr. 20160, 20161, 06609, 43288, 43289, 43290 dhe 43291, dhe për rrjedhojë nxjerr urdhrin ashtu si është përcaktuar më sipër.


D. Vërejtjet përmbledhëse

49. Vendimi dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar banesore.

50. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.

51. Vendimi i Komisionit nuk cenon të drejtën e paraqitësve të kërkesave ose mbajtësve të së drejtës pronësore për të kërkuar informacion për të drejtën e tyre

pronësore për pronat e kërkuara, para autoriteteve vendore kompetente të tilla si organet kadastrale ose gjykatat vendore, në pajtim me ligjin në fuqi.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA40740	KPA27081	KPA10340	KPA27079	KPA27080	KPA27082	KPA40940
KPA40941	KPA40942	KPA40943	KPA40944			

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA00036	KPA22830	KPA47326	KPA47327	KPA47328	KPA06609	KPA43288
KPA43289	KPA43290	KPA43291	KPA34698	KPA34699	KPA34700	KPA34701
KPA34702	KPA20160	KPA20161				